



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr. 1611/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Beni Dona Plast sh.p.k, me nr. unik identifikues 810545981, me seli në Prishtinë, Lagjia “Ulpiana” rr. “Imzot Nikë Prela” p.n, që sipas autorizimit përfaqësohet nga J.B., kundër debitorit Komuna e Kamenicës, që sipas autorizimit përfaqësohet nga J.B., me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.754/22 të datës 19.09.2023, me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Kamenicës, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.754/22 të datës 19.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.754/22 të datës 19.09.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Kamenicës i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 114/2021 të datës 19.07.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Myjesere Mujku.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të

ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.754/22 të datës 19.09.2023.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se faturat janë nënshkruar nga personat kompetent dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e specifikon se fatura duhet të jetë e protokolluar vetëm se të jetë e nënshkruar nga të dy palët në kuptim të dispozitave ligjore të LPP-së. Ka kërkuar që të hudhet poshtë si e palejuar ankesa e debitorit Komuna e Kamenicës.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Beni Dona Plast sh.p.k., me dt. 19.07.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumenteve: faturë nr. 13/21RT e datës 23.04.2021, faturë nr. 14/21DM e datës 23.04.2021, faturë nr. 15/21FN e datës 23.04.2021 dhe faturë nr. 16/21MK e datës 23.04.2021, urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,156.17 € (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e shtatëmbëdhjetë euro cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritjes për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimor.

Përmbartuesi Privat Myjsere Mujku me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.114/2021 dt. 19.07.2021 e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor, me arsyetimin se dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë, për faktin se të njëjtat nuk i përmbajnë elementet e domosdoshme që duhet t'i ketë një faturë, konkretisht të njëjtat nuk janë të nënshkruara nga zyrtari kompetent i debitorit dhe të njëjtat nuk janë të protokolluara në zyrën përkatëse të debitorit me vulën katrore, dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen si dokumente të besueshme.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke shtuar se kreditori ka faturuar debitorin pasi që ka bërë furnizimin me artikuj të ndryshëm higjienik në Komunën e Kamenicës, fakt ky që vërtetohet nga fletëdërgesa e bashkangjitura në propozimin për përmbarim, dhe secila faturë dhe fletëdërgesë përmban nënshkrimin e debitorit. Tutje ka shtuar se edhe në të kaluarën, secila faturë e dorëzuar nga kreditori është pranuar nga debitori përmes nënshkrimit, dhe ka mjaftuar nënshkrimi që debitori t'i përmbush këto fatura, çka vërtetohet edhe nga dëshmitë bankare të bashkangjitura në përgjigjen në prapësim

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.754/22 të datës 19.09.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Kamenicës i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 114/2021 të datës 19.07.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Myjesere Mujku.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se faturat nr. 13/21RT e datës 23.04.2021, nr. 14/21DM e datës 23.04.2021, nr. 15/21FN e datës 23.04.2021 dhe nr. 16/21MK e datës 23.04.2021 mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe fatura në fjalë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përmes nënshkrimit të faturave dhe fletëdërgesave të pranimit të mallit në emër të secilës faturë.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po qe se ne të është*

treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se faturat si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, prandaj konsiderohen si dokument i besueshëm. Po ashtu, faturat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali. dhe mbanë nënshkrimin e pranimin nga ana e debitorit. Andaj, faturat e lartcekura edhe pse nuk përmbajnë vulën e pranimin të njëjtat janë nënshkruar nga personi i autorizuar dhe konsiderohen si pranim i rregullt, pasi që debitori nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar në seancën dëgjimore ka pranuar se debitori faturat i ka pranuar nëpërmjet zyrtarëve të shkollave të cilat janë furnizuar e të cilat janë nën menagjimin e debitorit.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
K.DH.SH.II nr.1611/23 me datë 05.03.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami